



**KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS**

01. Nr. 06-3161/18
Klinë, 30.3.2018

**PROCESVERBALI
I SEANCËS SË TRETË TË KK, MBAJTUR, MË 30.3.2018, NË ORËN 10.00, NË
SALLËN E KK**

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, nënkryetari i Komunës, Besim Hoti, anëtarët e KK (27), drejtorë të drejtorive, Zyra ligjore, Policia e Kosovës, komandanti Rexhë Berisha, KFOR-i, OSBE, OJQ-të, mediet etj.

Seancën e udhëhoqi kryesuesi i KK, Fadil Gashi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë të KK-së. "Fillimisht besoj që keni marrë materialin bashkë me ftesën, duke respektuar edhe afatin ligjor, por shpresoj se anëtarët e Kuvendit iu kanë përmbajtur edhe afatit për plotësimin e atyre formularëve të deklarimit të pasurisë, se e keni ditën e fundit sot, besoj që e keni përfunduar këtë obligim që keni. Dhe ju informoj se në sallë jemi 26 anëtarë të Kuvendit, me arsye mungon Baki Gashi. Te rendi i ditës kisha pasur mirëkuptim nga anëtarët e Kuvendit, që prapë më duhet kërkuar një ndryshim të rendit të ditës dhe në këtë rast nëse pajtoheni e kishim bashkuar me pikën e fundit të rendit të ditës. Ju e keni parë se është shqyrtimi i peticionit të PLE dega në Klinë. Ne e kemi një peticion, ju e dini se kemi edhe obligim ligjor brenda afati 60 ditë për të shqyrtuar një peticion nëse i drejtohet Kryesuesit ose Kuvendit. Ne e kemi, jemi brenda afatit të shqyrtimit. Në të njëjtën kohë veç para dy ditëve e kemi marrë konfirmimin e joligjshmërisë të Komitetit për Komunitete nga MPL, sepse i kemi hequr ato femra që kanë qenë i kemi qitur te KPF. Tash ky është ndrequr, mirëpo është prishur tjetri. Nëse ju pajtoheni ne e kishim shqyrtuar bashkë me këtë peticionin se është për të njëjtin komitet bëhet fjalë, te komunitetet, edhe kishim formuluar rendin e ditës: Rishqyrtimi i kërkesës së MPL për komitetin për komunitete dhe shqyrtimi i peticionit. Kështu e kishim formuluar që të mos kemi pika shumë, nëse pajtoheni. Hapi debatin rreth rendit të ditës me këtë propozim që unë e bëra", ka shtuar kryesuesi Gashi.

Enver Berisha, tha se unë kisha kërkuar nga ju që të kemi një informacion shtesë për të gjitha komitetet e formuara, si është situata me to, edhe pse askush nga komitetet nuk kanë marrë informacion se janë zgjedhur dhe nuk ka filluar asnjë komitet për të funksionuar, duke përfshirë ndoshta komitetin më të rëndësishëm të KPF-së.

Fadil Gashi, tha se po e marrë një pjesë të përgjegjësisë, ndoshta në fillim nuk e thashë: për të gjitha kemi konfirmim se janë okej, të gjitha komitetet tjera dhe kjo ka qenë arsyeja derisa nuk kemi marrë këtë konfirmim nuk kemi mundur të thërrasim asnjë, s'kemi mundur të fillojmë

punën me këta trupa, të gjithë të tjerat besoj që në muajin që po hymë, në prill, veç fillojnë takimet e tyre, fillimisht konstituive, zgjedhja e kryesuesve të komiteteve edhe kalojmë në një punë normale. Ne kemi për obligim vetëm për ta sanuar Komitetet për Komunitete, anëtarët e tjerë e kanë marrë këtë konfirmim përmes adresës elektronike. Kjo është gjendja me të tjerët nuk kemi asnjë telashe”, shtoi kryesuesi Gashi.

Vuri në miratim rendin e ditës

Me vota unanime (26) u miratua ky

RENDI I DITËS

1. **Arsyetimi i mungesave,**
2. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,**
3. **Pyetje – përgjigje,**
4. **Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2017 (referon Ekzekutivi),**
5. **Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të viti 2017 në vitin 2018 (ref. Drejtoria e FEZH),**
6. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve bashkëfinancim me donatorë (Referon Drejtoria e FEZH),**
7. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Këshillit organizativ të Festivalit Folklorik “I këndojmë lirisë” (ref. DKRS),**
8. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës në afat të shkurtër dhe të gjatë,**
9. **Formimi i Komisionit të ankesave lidhur me shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim,**
10. **Rishqyrtimi i kërkesës së MPL për Komitetin për Komunitete dhe shqyrtimi i peticionit i Partisë Liberale Egjiptase - dega në Klinë.**

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi se mungon Baki Gashi, me arsye.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Enver Gashi, tha se numër 15 të propozimet për Komitetin për Shëndetësi, është shkruar prapë gabim: “Enver Berisha, LDK propozon dr. Augustin Selmanin. Këtu duhet të jetë “Enver Gashi (LDK) propozon Augustin Selmanin. Domethënë është hera e dytë që mbiemri më deformohet”, theksoi anëtari Gashi.

Enver Berisha, tha se unë jam i vetëdijshëm se edhe në të kaluarën na kanë përcjellë nga pak defekte në procesverbal të seancave të asamblesë, por duke llogaritur se tash stafi është i shtuar aty në kuadër të Zyrës së Kryesuesit më duket, por realisht mund të ndodh një defekt teknik, ku e thotë Enver Gashi, por realisht në analizën që i kam bërë fjalimit tim del që e humb kuptimin

fjalja tërësisht çka është thënë. “Unë nuk po ndalem tash në detaje, por parimisht po kërkoj, realisht është mirë që pak më me kujdes për ta hartuar hartimin e procesverbalit, bile-bile, unë e di që këtu ka njerëz nëse ka nevojë për ta bërë edhe ndonjë korrekturë, përkatësisht ndonjë lekturim, për të qenë krejt më saktë, është mirë të këqyret në të ardhmen për ta përmirësuar, sepse realisht po dalin fjalitë të pakuptimta, ka pohuar anëtari Berisha.

Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar me vërejtjet e bëra.

Me vota unanime (26) u miratua procesverbali me vërejtjet e bëra.

Pika e tretë: Pyetje – përgjigje.

Fadil Gashi, tha se i kemi përcaktuar minutat. “Kush ka pyetje?”

Esat Raci, tha se desha t’i drejtohem drejtorit të DKRS, e dimë që 4 Prilli është shpallur si Ditë e të pagjeturve në Komunën e Klinës, a keni punuar në këtë drejtim, përkatësisht a është formuar farë komisioni, edhe kush është në përbërjen e këtij komisioni?

Skënder Merturi, tha se me kohë kemi filluar përgatitjet për 4 Prillin, e kemi formuar KO. Në KO është Skënder Merturi, Fadil Gashi, Sevdije Ismaili, Blerim Gashi, Nexhmije Gashi, Alban Gashi. Këta janë 6 vetë, fillimisht ne kemi filluar më shpërndarjen e ftesave, agjenda është. Pritëm që në fund të seancës ta bëjmë ftesën edhe për asamblistët, e bën kryesuesi në fund të asamblesë. E pata konsideratën më 4 prill ju vjen agjenda në e-mail dhe e shihni agjendën edhe kush ka mundësi për t’u bashkëngjitur agjendës së 4 Prillit, jeni të mirëseardhur. Është menduar të shkohet në vizitë në Kralan, Pastasel, në Izbicë edhe te Pllaka përkujtimore për të vendosur lule, edhe një akademi përkujtimore që ka për t’u mbajtur në ora 12. Vjen kori i burrave i Pejës, e këndon Himnin kombëtar, janë fjalimet, kryetari i Komunës mban fjalim, edhe kjo është agjenda. Kemi filluar për t’u përgatitur”, sqaroi drejtori Merturi.

Esat Raci, tha se në natyrën e pyetjeve dhe përgjigjeve, a nuk e patë të arsyeshme që në mesin e komisionit të jetë Zeqir Morina? “Kontributin më të madh në nivel komune e ka dhënë Zeqir Morina sidomos për të pagjeturit”, shtoi anëtari Raci.

Skënder Merturi, tha se kur jam takuar me Zeqën dhe kur e kam pyetur se a është në dakord me këtë, ai është pajtuar me anëtarët e komisionit.

Zeqir Morina, theksoi se mbasi është formuar ai Këshill organizativ më ke pyetur dhe të kam thënë është në rregull, kaq. “Nuk kam asgjë, mirëpo është shumë e vërtetë që menjëherë pas përfundim të luftës me vendim të Bordit të drejtorëve jam caktuar udhëheqës, përkatësisht përfaqësues për persona të pagjetur në Komunën e Klinës, bile është dashur ai që ka udhëhequr, ose ka harruar ose për ndonjë qëllim tjetër të caktuar, megjithatë nuk ka ndonjë problem ajo çështje”, tha anëtari Morina.

Skënder Merturi, tha se ne kemi menduar se Sevdija është edhe pjesë e shoqatës dhe pjesë e Komunës, prandaj për këtë shkak edhe e kemi emëruar anëtarë të këtij komisioni. “Nuk kemi pasur kurrfarë qëllimi të caktuar”, pohoi drejtori Merturi.



**KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS**

01. Nr. _____

Klinë, 30.3.2018

**PROCESVERBALI
I SEANCËS SË TRETË TË KK, MBAJTUR, MË 30.3.2018, NË ORËN 10.00, NË
SALLËN E KK**

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, nënkryetari i Komunës, Besim Hoti, anëtarët e KK (27), drejtorë të drejtorive, Zyra ligjore, Policia e Kosovës, komandanti Rexhë Berisha, KFOR-i, OSBE, OJQ-të, mediet etj.

Seancën e udhëhoqi kryesuesi i KK, Fadil Gashi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë të KK-së. "Fillimisht besoj që keni marrë materialin bashkë me ftesën, duke respektuar edhe afatin ligjor, por shpresoj se anëtarët e Kuvendit iu kanë përmbajtur edhe afatit për plotësimin e atyre formularëve të deklarimit të pasurisë, se e keni ditën e fundit sot, besoj që e keni përfunduar këtë obligim që keni. Dhe ju informoj se në sallë jemi 26 anëtarë të Kuvendit, me arsye mungon Baki Gashi. Te rendi i ditës kisha pasur mirëkuptim nga anëtarët e Kuvendit, që prapë më duhet kërkuar një ndryshim të rendit të ditës dhe në këtë rast nëse pajtoheni e kishim bashkuar me pikën e fundit të rendit të ditës. Ju e keni parë se është shqyrtimi i peticionit të PLE dega në Klinë. Ne e kemi një peticion, ju e dini se kemi edhe obligim ligjor brenda afati 60 ditë për të shqyrtuar një peticion nëse i drejtohet Kryesuesit ose Kuvendit. Ne e kemi, jemi brenda afatit të shqyrtimit. Në të njëjtën kohë veç para dy ditëve e kemi marrë konfirmimin e joligjshmërisë të Komitetit për Komunitete nga MPL, sepse i kemi hequr ato femra që kanë qenë i kemi qitur te KPF. Tash ky është ndrequr, mirëpo është prishur tjetri. Nëse ju pajtoheni ne e kishim shqyrtuar bashkë me këtë peticionin se është për të njëjtin komitet bëhet fjalë, te komunitetet, edhe kishim formuluar rendin e ditës: Rishqyrtimi i kërkesës së MPL për komitetin për komunitete dhe shqyrtimi i peticionit. Kështu e kishim formuluar që të mos kemi pika shumë, nëse pajtoheni. Hapi debatin rreth rendit të ditës me këtë propozim që unë e bëra", ka shtuar kryesuesi Gashi.

Enver Berisha, tha se unë kisha kërkuar nga ju që të kemi një informacion shtesë për të gjitha komitetet e formuara, si është situata me to, edhe pse askush nga komitetet nuk kanë marrë informacion se janë zgjedhur dhe nuk ka filluar asnjë komitet për të funksionuar, duke përfshirë ndoshta komitetin më të rëndësishëm të KPF-së.

Fadil Gashi, tha se po e marrë një pjesë të përgjegjësisë, ndoshta në fillim nuk e thashë: për të gjitha kemi konfirmim se janë okej, të gjitha komitetet tjera dhe kjo ka qenë arsyeja derisa nuk kemi marrë këtë konfirmim nuk kemi mundur të thërrasim asnjë, s'kemi mundur të fillojmë

punën me këta trupa, të gjithë të tjerat besoj që në muajin që po hymë, në prill, veç fillojnë takimet e tyre, fillimisht konstituive, zgjedhja e kryesuesve të komiteteve edhe kalojmë në një punë normale. Ne kemi për obligim vetëm për ta sanuar Komitetet për Komunitete, anëtarët e tjerë e kanë marrë këtë konfirmim përmes adresës elektronike. Kjo është gjendja me të tjerët nuk kemi asnjë telashe”, shtoi kryesuesi Gashi.

Vuri në miratim rendin e ditës

Me vota unanime (26) u miratua ky

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Pyetje – përgjigje,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2017 (referon Ekzekutivi),
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve të mbetura nga të hyrat vetanake të viti 2017 në vitin 2018 (ref. Drejtoria e FEZH),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve bashkëfinancim me donatorë (Referon Drejtoria e FEZH),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Këshillit organizativ të Festivalit Folklorik “I këndojmë lirisë” (ref. DKRS),
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës në afat të shkurtër dhe të gjatë,
9. Formimi i Komisionit të ankesave lidhur me shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim,
10. Rishqyrtimi i kërkesës së MPL për Komitetin për Komunitete dhe shqyrtimi i petitionit i Partisë Liberale Egjiptase - dega në Klinë.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi se mungon Baki Gashi, me arsye.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Enver Gashi, tha se numër 15 te propozimet për Komitetin për Shëndetësi, është shkruar prapë gabim: “Enver Berisha, LDK propozon dr. Augustin Selmanin. Këtu duhet të jetë “Enver Gashi (LDK) propozon Augustin Selmanin. Domethënë është hera e dytë që mbiemri më deformohet”, theksoi anëtari Gashi.

Enver Berisha, tha se unë jam i vetëdijshëm se edhe në të kaluarën na kanë përcjellë nga pak defekte në procesverbal të seancave të asamblesë, por duke llogaritur se tash stafi është i shtuar aty në kuadër të Zyrës së Kryesuesit më duket, por realisht mund të ndodh një defekt teknik, ku e thotë Enver Gashi, por realisht në analizën që i kam bërë fjalimit tim del që e humb kuptimin

fjalja tërësisht çka është thënë. “Unë nuk po ndalem tash në detaje, por parimisht po kërkoj, realisht është mirë që pak më me kujdes për ta hartuar hartimin e procesverbalit, bile-bile, unë e di që këtu ka njerëz nëse ka nevojë për ta bërë edhe ndonjë korrekturë, përkatësisht ndonjë lekturim, për të qenë krejt më saktë, është mirë të këqyret në të ardhmen për ta përmirësuar, sepse realisht po dalin fjalitë të pakuptimta, ka pohuar anëtari Berisha.

Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar me vërejtjet e bëra.

Me vota unanime (26) u miratua procesverbali me vërejtjet e bëra.

Pika e tretë: Pyetje – përgjigje.

Fadil Gashi, tha se i kemi përcaktuar minutat. “Kush ka pyetje?”

Esat Raci, tha se desha t’i drejtohem drejtorit të DKRS, e dimë që 4 Prilli është shpallur si Ditë e të pagjeturve në Komunën e Klinës, a keni punuar në këtë drejtim, përkatësisht a është formuar farë komisioni, edhe kush është në përbërjen e këtij komisioni?

Skënder Merturi, tha se me kohë kemi filluar përgatitjet për 4 Prillin, e kemi formuar KO. Në KO është Skënder Merturi, Fadil Gashi, Sevdije Ismaili, Blerim Gashi, Nexhmije Gashi, Alban Gashi. Këta janë 6 vetë, fillimisht ne kemi filluar më shpërndarjen e ftesave, agjenda është. Pritëm që në fund të seancës ta bëjmë ftesën edhe për asamblastët, e bën kryesuesi në fund të asamblesë. E pata konsideratën më 4 prill ju vjen agjenda në e-mail dhe e shihni agjendën edhe kush ka mundësi për t’u bashkëngjitur agjendës së 4 Prillit, jeni të mirëseardhur. Është menduar të shkohet në vizitë në Kralan, Pastasel, në Izbicë edhe te Pllaka përkujtimore për të vendosur lule, edhe një akademi përkujtimore që ka për t’u mbajtur në ora 12. Vjen kori i burrave i Pejës, e këndon Himnin kombëtar, janë fjalimet, kryetari i Komunës mban fjalim, edhe kjo është agjenda. Kemi filluar për t’u përgatitur”, sqaroi drejtori Merturi.

Esat Raci, tha se në natyrën e pyetjeve dhe përgjigjeve, a nuk e patë të arsyeshme që në mesin e komisionit të jetë Zeqir Morina? “Kontributin më të madh në nivel komune e ka dhënë Zeqir Morina sidomos për të pagjeturit”, shtoi anëtari Raci.

Skënder Merturi, tha se kur jam takuar me Zeqën dhe kur e kam pyetur se a është në dakord me këtë, ai është pajtuar me anëtarët e komisionit.

Zeqir Morina, theksoi se mbasi është formuar ai Këshill organizativ më ke pyetur dhe të kam thënë është në rregull, kaq. “Nuk kam asgjë, mirëpo është shumë e vërtetë që menjëherë pas përfundim të luftës me vendim të Bordit të drejtorëve jam caktuar udhëheqës, përkatësisht përfaqësues për persona të pagjetur në Komunën e Klinës, bile është dashur ai që ka udhëhequr, ose ka harruar ose për ndonjë qëllim tjetër të caktuar, megjithatë nuk ka ndonjë problem ajo çështje”, tha anëtari Morina.

Skënder Merturi, tha se ne kemi menduar se Sevdija është edhe pjesë e shoqatës dhe pjesë e Komunës, prandaj për këtë shkak edhe e kemi emëruar anëtarë të këtij komisioni. “Nuk kemi pasur kurrfarë qëllimi të caktuar”, pohoi drejtori Merturi.

Fadil Gashi, tha se Zeqa është pjesë e tyre. “Ju e dini që me vendim të Kuvendit 4 Prilli është shpallur ditë e të zhdukurve. Edhe në kuptimin e organizimit më shumë ideja ka qenë për t’u marrë drejtoria, le të merret si drejtori me kapacitetet dhe mundësitë që i ka, prandaj nuk e kanë angazhuar as Zeqën, as të tjerët. Me rëndësi për t’i përkujtuar ata që sot na mungojnë. Nuk është ndonjë privilegj që është aty”, shtoi kryesuesi.

Tunë Dedaj, tha se unë edhe gjatë mandatit të kaluar jam angazhuar që të zbatohet ndalimi i pirjes së duhanit nëpër lokale të Komunës së Klinës, mirëpo nuk ka ndodhur. “E kam një kërkesë personale, një kërkesë në emër të shumicës së atyre që më kanë zgjedhur mua që të jem sot këtu, që prej ditës së nesërme duhani të ndalohej të pihet në vende publike nëpër lokale të Klinës. Ju e dini që shkaktarët e kancerit është duhani, nuk di si tolerohet pirja e tij në lokalet publike. Kërkoj nga drejtori dhe inspektorët që prej nesër t’i çon inspektorët t’i njoftojnë një herë, të mos ju jap dënime, mirëpo në fund të fundit duhet zbatuar ligjin”, ka shtuar anëtari Deda.

Enver Gashi, tha se kam një pyetje për drejtorin e Shërbimeve publike, ose Kryetari i Komunës të më përgjigjet: dua ta paraqes një shqetësim të madh të qytetarëve të Komunës sonë, e në veçanti të qytetarëve të BL të Sferkës, Volljak, Qupevë, Përqevë, problemi i qenve endacakë, ku më së shumti janë të atakuar nxënësit gjatë shkuarjes në shkolla. “A ka mundësi që ky problem të zgjidhet”, ka shtuar anëtari Gashi.

Ibër Elezaj, tha se është një program nacional për zgjidhjen e problemit të qenve endacakë, nuk është problem vetëm i Komunës së Klinës, mirëpo është problem nacional i krejt Kosovës. “Edhe në këtë aspekte AVUK-u, Agjencioni i Veterinës së Kosovës e ka marrë për të udhëhequr këtë projekt për vitin 2018. Janë diku 1 milion dy-treqind mijë euro, edhe ka filluar projekti. Janë identifikuar në çdo komunë veterinarët apo stacionet veterinarë. Këtu në Klinë i kemi tre persona që janë identifikuar, janë profesionistë dhe kanë për të filluar së shpejti. Mirëpo, për këtë vit Komuna nuk ka program për këtë punë për shkak se i takon nivelit qendror. Vitin tjetër, ashtu siç na është thënë, atëherë kompetencat barten në nivel komunal”, ka theksuar drejtori Elezaj.

Valmir Bacaj, tha se unë kam një pyetje për drejtorin e DKA-së, pyetja ka të bëjë rreth dy shkollave fillore të mesme të ultë që është “Motrat Qiriazhi në Klinë dhe SHFMU “Ismet Rraci.” Përderisa shkolla fillore “Ismet Rraci ka mbingarkesë të nxënësve në paralelet e caktuara, ndërsa shkolla fillore e mesme “Motrat Qiriazhi” ka mungesë të nxënësve në paralelet e njëjta. Ky shqetësim ka qenë i mësimdhënësve për gjithë këto vite. Pyetja është: a ka ndonjë vendim të AK në të kaluarën që do të bënte ndarjen territoriale në lagjet, në mënyrë që cilat lagje t’i dërgojnë nxënësit në shkollën “Ismet Rraci” dhe cilat në shkollën “Motrat Qiriazhi”. Sepse në bazë të UA numri optimal i nxënësve është 30, ndërsa në shkollën “Ismet Rraci” ka raste që e tejkalon këtë numër, që ka shkuar edhe deri 44. Dhe nëse nuk ekziston një vendim i tillë, a konsideroni se një vendim i tillë i nxjerrë nga AK, A konsideroni se një vendim i tillë i nxjerrë nga AK ngrit cilësinë e arsimit në këto dy shkolla”, ka konstatuar anëtari Bacaj.

Arben Limani, theksoi se shqetësimi i anëtarit të Kuvendit besoj që është me vend, pasi që kjo çështje është diskutuar edhe më herët, po ashtu është marrë edhe një vendim për zonat e mbulimit në KK, mirëpo është pak problem për të menaxhuar situatën edhe për t’i definuar për t’i obliguar prindërit për të zgjedhur arsimtarin. “Këtë telashe e kemi edhe e dimë që numri në

shkollën “Ismet Rraci”, është i stërngarkuar, ka klasë edhe me 40 nxënës. Ndërsa shkolla afër po në qytet ka mungesë ndoshta në paralele të caktuara edhe me plotësim të numrit të nxënësve për klasë. Me këtë çështje ndoshta duhet të merremi prapë si KK, ta definojmë ndoshta edhe më qartë këtë çështje. Unë thashë është pak problem me i obliguar prindërit ku ta dërgojnë fëmijën në shkollë prej klasës së parë”, ka sqaruar drejtori Limani.

Xhezide Trepca - Gashi, tha se kam një pyetje: pse nuk kanë pasur përfaqësues komuniteti me aftësi të kufizuara në këshillin komunal të sigurisë në bashkësi, duke pasur parasysh se përfaqësimi i tyre në këtë këshill është i domosdoshëm, sepse kjo kategori e shoqërisë meriton përkrahje morale dhe institucionale.

Fadil Gashi, tha se po marr të drejtën të përgjigjem unë, se ju keni qenë në seancë ku kemi lënë hapësirën SHC, edhe kësaj kategorie, për t’i prurë propozimet, deri sot nuk ka prurë kush propozim, edhe kjo është gjendja”, ka sqaruar Kryesuesi.

Tush Dedaj, tha se në seancën e kaluar kam ngrehur çështjen e fshatit Dresnik çka është bërë prej pavarësisë? Nuk di a duhet të thirret në interpelancë apo në një farë mënyre të na jepet ndonjë përgjigje. Nuk po e shpejtoj, mirëpo ka mundësi edhe më vonë për të folur për atë punë, për arsye se edhe tash, edhe atëherë Dresniku është lagje e Klinës. Të gjitha rrugët që ndahen prej Kline në periferi dhe fshatrat përreth janë të asfaltuara, të shtruara, vetëm e Dresnikut nuk është! Është e pakalueshme! Edhe një çështje tjetër për drejtorin e Arsimit, e kam një pyetje: Pse kur dalin punëtorët e arsimit në pension iu ndërpritet puna dhe menjëherë nuk gjendet njeri që zëvendëson atë. E kemi shembullin e Lekë Lekajt, ka dalë në pension nuk ka njeri që zëvendëson. Disa herë e shoh që defilojnë njerëzit dhe nuk di kush kujdeset për ta”, theksoi anëtari Dedaj.

Fadil Gashi, tha se ju kisha lutur shumë shkurt sepse i kemi kaluar minutat e përcaktuar dhe të kemi konsideratë edhe drejtorët shkurt le të përgjigjen.

Arben Limani, tha se çështja e profesorit Lekë Leka është shqetësim me vend i prezantuar nga anëtari i Kuvendit, mirëpo siç e dini ju profesori Lekë është i sëmurë që një kohë të gjatë, edhe ne kemi dërguar arsimtarë nga shkollat tjera për t’i mbajtur orët e tij vetëm për të mos e larguar nga lista e pagave. “Për t’i mbajtur orët e tij ne kemi ngarkuar arsimtarë të shkollave të tjera, meqë shkolla e mesme nuk ka më shumë se dy muaj e diçka që përfundon mësimin, atëherë kemi menduar që me konkursin që do të shpallet në fund të qershorit për gjithë kuadrin arsimor atëherë ta rregullojmë edhe çështjen e kuadrit mësimdhënës për gjuhën angleze. Meqë afati deri në përfundim të vitit është, mund të jenë 2 ose 3 muaj, e kemi lënë për arsye që i cekam më lartë që ta shpallim posa të përfundojë viti shkollor. Nuk ka ndonjë shqetësim se orët vec janë duke u mbajtur, përkatësisht orët janë duke u zëvendësuar”, ka shtuar drejtori Limani.

Gjokë Lleshaj, tha se koha e limituar për 10 minuta ndoshta pak duhet gjetur mirëkuptim, a ka mundësi, apo a ka ndonjë rregullore që e rregullon, pavarësisht vullnetit tuaj. A ka mundësi që kur ka biseda të tilla të mos jetë e limituar, sepse sikur po e kemi të cenuar këtë kohë. Pyetja e dytë kishte për të shkuar për drejtorin e SHP, një pyetje krejt e thjeshtë, mirëpo meqenëse e potencoi rreth qenve endacakë në mos gabofsha. E di që kur kam qenë në mandatin e kalua drejtor i kësaj drejtorie, kam bërë një kërkesë për mjete, që Ramush Haradinaj, ka kërkuar që

urgjentisht të shqyrtohet, të analizohet shuma për eliminimin e qenve endacakë. A ka diçka konkret apo vetëm kanë qenë fjalë, apo vetëm ka qenë kërkesë për sy e faqe. Dy shkresa i kam bërë, edhe a kanë ndërmarrë diçka për të stimuluar apo vetëm kanë qenë vetëm premtime”, ka shtuar anëtari Lleshaj.

Fadil Gashi, tha se prej vullnetit të mirë që pyetje - përgjigjet nuk ka ndonjë kufizim në kuptimin e pyetjes e përgjigjes mund të ketë, se ti e merr pyetjen dhe përgjigjesh brenda saj. Te koha, kërkesa jonë është se nuk kemi mundësi të vazhdojmë më shumë se 10 minuta. Por, keni parasysh, këtë hapësirë e kemi lënë për të qenë racionale, për të qenë e momentit për një çështje për një diçka që është në interes të përgjithshëm, e bën një pyetje e merr përgjigjen. Nuk është e thënë që drejtorët sot për ta dhënë përgjigjen, mund ta dhënë në seancën e radhës. Domethënë ju nuk jeni të kufizuar sot të formuloni pyetje edhe me shkrim në shërbim të kuvendit, secila drejtori e merr pyetjen tuaj dhe në seancën e radhës ju jep edhe përgjigjen. Këtë kohë e kemi vu për çështjet që janë pak më të rëndësishme së veçantë dhe pyetjet a është kjo apo nuk është kjo, po hyni ju dhe po sqaroni”, ka shtuar kryesuesi Gashi.

Ibër Elezaj, tha se Gjokë kërkesat tuaja i kam shqyrtuar, mirëpo kjo parë që është dhënë në nivel të Kosovës është nivel i qeverisë. “Kështu që të gjitha kërkesat edhe të komunave të tjera, sepse kërkesa kanë pasur edhe komunat tjera, domethënë janë bashkuar në një fond të përbashkët, kështu që tash ky fond është koncentruar në nivel të Kosovës dhe AVUK-u merret me këtë çështje, ka sqaruar drejtori Elezaj.

Fadil Gashi, te pyetja të zonja Xhezide, sqaroi se komuniteti i personave me aftësi të kufizuara tashmë veç e paska prurë emrin e anëtarit të komisionit, Halim Morina.

Pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2017 (referon Ekzekutivi).

Kryesuesi fjalën e barti te drejtori i Drejtorisë së FEZH, z. Aziz Desku.

Lidhur me Raportin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2017, një fjalë hyrëse e paraqiti drejtori i drejtorisë së FEZH, Aziz Desku. Fjala hyrëse ishte një ekstrakt i nxjerrë nga Raporti i Punës së Ekzekutivit për vitin 2017, duke përshkruar aspektet kryesore të punës dhe aktiviteteve të zhvilluara nga drejtoritë e Komunës së Klinës.

“Viti 2017 karakterizohet për ekzekutivin komunal si vit i realizimit të synimeve dhe objektivave te parapara sipas Ligjeve aplikative në fuqi, duke shënuar shumë të arritura dhe angazhime të Administratës Komunale, më qellim që të arrihen kushte sa më të mira për qytetaret e kësaj Komune.

Administrata komunale gjatë periudhës 2017 ishte funksionale dhe efikase në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe profesionale të qytetarëve, në riorganizimin profesional dhe reformimin krahas reformës së administratës publike, punën transparente më media, OJQ shoqëri civile, duke ofruar qasje në dokumentet zyrtare, duke demonstruar qeverisje transparente dhe komunikim dhe qasje transparente më qytetaret”, ka konstatuar ndër të tjera drejtori Desku.

Kryesuesi hapi debatin rreth raportit.

Tunë Dedaj, theksoi se do të ishte mirë po se është çdo gjë mirë, mirëpo kam vërejtur diçka të çuditshme që dashtë zoti të jetë gabim e të mos jetë e vërtetë ajo që është punuar. “Gjatë vitit 2017 janë hartuar dhe përpunuar përmasat e parallogarisë: është bërë ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës, siç vijon: Projektet e realizuar për vitin 2017. Vetëm dua të merrem me Deiqin, asfaltimi i rrugës në Deiq, segmenti i parë dhe i dytë. Asfaltimi i rrugës në Deiq, segmenti i tretë. Ju them të drejtën kjo asamble e ka pasur votuar vetëm një asfalt që është shtruar dhe është shtruar shkëlqyeshëm, e di që është shtruar edhe një asfalt në një lagje, ku janë 2-3 shtëpi, edhe atë gëzohem që është shtruar, por këtë pjesën e tretë të asfaltit nuk di ku është shtruar. Nuk është shtruar në Deiq, kisha për të kërkuar prej organeve kompetente për ta kërkuar dhe për ta gjetur, se ne e dimë sa kushton një asfalt. Nuk isha thënë kurrë që të thuhet asfalti është shtruar në Deiq e të shtrohet diku tjetër, prandaj kërkoj prej organizatave kompetente, më vjen keq që nuk po ndodhte këtu Bakiu, për t’ia thënë, por është mirë, kryesues këtë gjë të mos tejkaluar kështu.

Gjokë Lleshaj, tha se po më pëlqen Tuna që ka realizuar në Deiq, se mëndët e kanë pasur lënë vetëm për Deiqin, duke menduar që s’ka katund tjetër përpos Deiqit, por ka edhe lokalitete tjera, mirë është për të dalë edhe përtej Deiqit, nuk është vetëm Deiqi në Komunën e Klinës, por edhe shumë Deiq të tjera. Mirëpo, unë desha vetëm se kryesuesi e tha na ka lëvdur shumë, megjithatë jo edhe aq shumë na i ka lënë edhe disa gjera mangu, ndoshta me meritë apo pa meritë, megjithatë mund t’i shqyrtojmë. Pavarësisht që punët që i kemi bërë mandatin e kaluar ose vitin e kaluar, DSHP nuk është cekur që ka fituar donacionin prej 293 mijë euro, që ka pasur shumë rezerva, vitin e kaluar e kemi fituar këtë donacion, por megjithatë kjo është shumë e vërtetë, mbetet vetëm implementim. Po ashtu edhe një donacion tjetër për meremetimin e shkollës në Jagodë, në vlerë prej 58 mijë euro, që unë jam gëzuar që është realizuar kërkesë jona, mirëpo ata kanë dhënë pak më shumë. Kemi bërë edhe shumë punë tjera. Besoj dhe uroj që të vazhdojë puna e mirë për të gjitha fshatrat dhe për gjithë komunitetin që jetojnë në komunën e Klinës”, ka shtuar anëtari Lleshaj.

Fadil Gashi, theksoi fillimisht se është ekstrakt, në raport i keni edhe ato që po i kërkon. “Janë 45 faqe të gjitha janë të përfshira në raport. Se sa është punuar ne njerëz jemi”, shtoi kryesuesi.

Tunë Dedaj, tha se pajtohem me Gjokën se kam kërkuar të punohet në Deiq që është lënë anësh, edhe Dresniku është shumë e vërtetë që është lënë anësh. “Mirëpo ne do të punojmë në Dresnik. Unë nuk kërkova, s’e kundërshtova, mirëpo thashë se kam dëshirë ta gjej asfaltin por nuk është, nuk ka asfalt. aty nuk kam asfalt, dëshiroj ta gjej por nuk mund ta gjej, sepse nuk ka asfalt aty”, shtoi anëtari Dedaj. .

Fadil Gashi, theksoi se mund ta vërtetojmë a ka apo nuk ka, asfalti shihet.

Shqipnore Dauti, tha se më vjen mirë që u potencuan rastet port gabimet drejtshkrimore, unë i përkas kësaj lëmie. “Unë në 9 rreshta hasa 16 gabime drejtshkrimore! Dhe, më shqetëson se një raport, siç është ky, nuk tolerohen gabime të këtilla. Mirëpo, shpresojmë se në raportet tjera nuk do të ketë gabime drejtshkrimore”, theksoi anëtarja Dauti.

Fadil Gashi, tha se po pajtohem me pikë e presje, mirëpo pakës si urgjente ka qenë hartimi i këtij raporti. “Gabimet na kanë përcjellë në vazhdimësi dhe shpresojmë se do të shkojmë duke i evituar”, shtoi Kryesuesi.

Enver Berisha, tha se po dua ta falënderoj drejtorin për Buxhet dhe Financa, i cili për dallim prej raportit të kaluar sot ka qenë jashtëzakonisht shumë korrekt. “I vetëdijshëm se është problematike për ta përfaqësuar krejt atë punë që dikush tjetër e ka kryer dhe të mos ketë mangësi të caktuar, por po shihet se i gjithë angazhimi edhe i tij, edhe i stafit tjerë i Ekzekutivit ka qenë të bëhet harmonizimi sa më i mirë i këtij raporti, por jo gjithherë duke mos qenë autorë i tërë këtij procesi, sepse kanë qenë drejtorë tjerë dhe gabimet mund të përvidhen, por realisht një vullnet i mirë, një prezantim që realisht është ky që është. I Vetëdijshëm që janë kryer shumë punë vitin e kaluar, por pa përjashtuar mundësinë dhe obligimit që ju i keni tash, që edhe aty ku nuk është kryer një punë, aty ka nevojë të ndërhyhet këtë vit. Mirëpo, unë në emër të GP të PDK-së, duke pasur parasysh që kemi qenë ne ata që realisht jemi në krejt këtë raport të këtij ekzekutivi, e mbështesim dhe e falënderojmë edhe një herë drejtorin për Buxhet dhe Financa dhe ekzekutivin për prezantimin e këtij raporti. Shpresoj që bashkërisht edhe më tutje të jemi më në nivel të përgjegjësive që kemi marrë, në rend të parë këtu si asamblistë që jemi me votën e qytetarëve, por edhe si ekzekutiv që realisht e keni mandatin edhe përgjegjësinë që të jeni në funksion dhe në shërbim të projekteve që qytetarët presin nga ne”, ka konstatuar anëtari Berisha.

Kryesuesi vuri në miratim raportin me diskutimet që u thanë.

Me vota unanime (26), pa kundër as abstenime, u miratua Raporti i Punës së Ekzekutivit për vitin 2017.

Pika e pestë: Shqyrtimi i propozim-vendimit për barjten e mjeteve nga të hyrat vetanake për vitin 2017 në vitin 2018.

Kryesuesi fjalën e barti te drejtori i DEZH, z. Aziz Desku.

Kryesuesi fjalën për raportim e barti te z. Aziz Desku, drejtor i Drejtorisë së FEZH.

Aziz Desku, raportoi rreth propozim-vendimit për bartjen e mjeteve bashkëfinancim me donatorë. Drejtori Desku i njoftoi anëtarët e Kuvendit lidhur me shumën e mjeteve për bartje sipas kategorive ekonomike, shërbime komunale, subvencione dhe shpenzime kapitale, sipas specifikave në Propozim-vendim për bartje.

- Të hyrat vetanake të vitit 2017 në total janë në shumën prej 217.543,36 €, të cilat i bartim për vitin 2018 dhe shpërndarja e tyre është nëpër programet dhe nën-programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike të shpenzimeve, si vijon:
- Paga dhe mëditje në shumë prej 953.00 €;
- Mallra dhe shërbime në shumë prej 16,388.00 €;
- Shpenzime komunale në shumë prej 568.00 €;
- Subvencione dhe transfere në shumë prej 20,685.00 €;

- Shpenzime kapitale në shumë prej 178,949.36 €.

Në materialin që keni marrë për këtë pikë të rendit të ditës, domethënë ajo cka është më e rëndësishme ndoshta është këtu te bartja e mjeteve ëpr projektet kapitale, që në faqen e dytë të këtij materialin janë të listuara projektet për të cilat barten mjetet, respektivisht të cilat ka të bëjë me projektet që janë vazhdimësi nga viti i kaluar dhe që bartin obligime për realizimin e tyre për vitin 2018. Unë më shumë nuk kisha për t'u ndalur rreth këtij propozim – vendimi për bartje të mjeteve. Nëse ndokush do të ketë ndonjë pyetje specifike kishim mundur për të dhënë sqarime të nevojshme.

Fadil Gashi, theksoi se është një bartje e natyrshme.

Vuri në miratim.

U miratua me 24 vota për pa kundër as abstenim.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve bashkëfinancim me donatorë (Referon Drejtoria e FEZH).

Aziz Desku, tha se në material keni një projekt-vendim, po që se aprovohet nga ana juaj merr formën e vendimit për bartjen e mjeteve nga kodi i projekteve bashkëfinancim me donatorë, për tri projekte që kemi përmendur në këtë vendim dhe besoj që kjo ndoshta nuk ka qenë praktike në mandatin e kaluar. “Meqenëse projekti bashkëfinancim me donatorë, është në një vlerë të madhe financiare prej të cilave intervenohet me projekte të ndryshme me bashkëfinancim me donator të mundshëm të komunës, atëherë dhe meqenëse disa projekte gjatë realizimit të tyre mund të kenë tejkalim të vlerës nga ajo që është planifikuar. Kostoja e projektit gjatë aprovimit të buxhetit, atëherë për të qenë edhe më transparente dhe më korrekte, në raport edhe me anëtarët e Kuvendit komunal, por edhe me qytetarët kemi menduar që prej kodit të projekteve bashkëfinancim me donator, kur kërkohet bartje e mjeteve për projekte të caktuara, atëherë e marrim edhe miratimin e Kuvendit komunal. Domethënë ne kemi menduar për asfaltimin e rrugës në Pograxhë nga kodi i projektit me donator të ndahet një vlerë shtesë prej 20 mijë euro; po ashtu 7 mijë euro është menduar që prej kodit bashkëfinancim me donator të ndahen për kanalin për ujitje në Grabanicë-Zajm, si dhe 18.300 për projektin e kanalizimit në Zllakuqan, që edhe ky është në fazën e tenderimit, respektivisht vlerat e ofertave kanë dhënë një vlerë më të madhe nga ajo që është planifikuar. Për të gjitha këto kemi dashur që të marrim edhe miratimin e Kuvendit komunal në mënyrë që të mund të procedojmë më tutje me bartjen e këtyre mjeteve”, ka konstatuar drejtori Desku.

Tush Dedaj, tha se rreth rrugës së Pograxhës, a ka mundësi të na sqarohet prej nga deri ku dhe sa kilometra rrugë janë për t'u asfaltuar. “A është prej Kodrës deri ne fshat, apo pjesë tjera të fshatit. Kisha thënë se të gjitha këto projekte le ta kenë një gjatësi, prej ku fillon dhe deri ku përfundon, për të pasur mundësi ta marrim se ku është urgjenca e këtij intervenimit”, shtoi anëtari Dedaj.

Zenun Elezaj, sqaroi interesimin e anëtarit Dedaj. “Për rrugët në fshatin Pograxhë ka qenë projekti i hartuar dhe unë personalisht kam dalë dhe e kam vizituar. Rruga nga Kodra dhe I

përfshinë dy lagjet, lagjen e Gjergjajve edhe Toplanaj. Do të thotë janë deri në fund të lagjeve. Projekti ka qenë i kryer nga qeverisja e kaluar, por ne vetëm e kemi shpallur tenderin. Ka dalë që rruga e ka diku gjatësinë prej 3 mijë metra, në mos gaboj. Por sidoqoftë nëse ju kërkoni mund ta sigurojmë në Urbanizëm. Nuk kemi mundur për ta përfshirë gjithë fshatin, vetëm dy rrugë, por që ka shkuar deri në fund të lagjeve.

Kryesuesi vuri në miratim.

U miratua unanimisht (26).

Pika e shtatë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për subvencionimin e klubeve sportive të Komunës së Klinës.

Kryesuesi fjalën e barti te drejtori I DKRS, Skënder Merturi.

Skënder Merturi, tha se në vazhden e përkrahjes së klubeve sportive dhe për herë të parë po bëhet subvencionimi i të gjitha klubeve që janë të regjistruara Komunën e Klinës. “Deri me tani kemi 10 klube të regjistruara në të cilat duhet për t’i subvencionuar. E di që ka për të pasur pakënaqësi, por siç është një fjalë e popullit” “Shtrijë këmbët për aq sa është jorgani”. Edhe në këtë rast ne jemi munduar për të qenë korrekt edhe kemi bërë një propozim, që i takon asamblesë për të marrë vendimin. Për KF “Dukagjini” të meshkujve është menduar 300 mijë euro, KF I femrave 6 mijë; klubi i volejbollit për femra 2 mijë, KH për meshkuj është një ndryshim këtu e keni të shkruar 2500, është një propozim I ri pasi që është menduar që ata janë afër futjes në ligë, e kemi menduar një përkrahje dhe propozimi është 4 mijë; KB meshkujt për herë të parë që funksionon, është 2 mijë, KH për femra 150. Ne kemi menduar për shkak se janë femra me i përkrahur, kemi menduar më shkuar 250, KH i femrave 2500, Klubi i ping-pongut 500, KSH kemi menduar me 500, edhe Aeuro – klub i “Klina” me 500. Këto janë mjetet tona, kjo është mundësia jonë. Unë kisha kërkuar përkrahjen tuaj , besoj që herëve të tjera nuk ka për të munguar përkrahja e sportit, përkrahja e klubeve sportive, edhe përkrahja e të rinjve dhe të rejave të Klinës, por kësaj radhe kaq është mundësia, megjithatë ju mbetet juve si asamble për të vendosur për ndryshimet dhe propozimet e reja, ne jemi këtu”, ka shtuar drejtori Merturi.

Esat Raci, tha se e këtu në material po figuron shprehja “Lleshi”, çka është?

Skënder Merturi, sqaroi interesimin e anëtarit Raci se është “Aero-klubi”.

Enver Berisha, tha se fillimisht e përshëndes këtë ndarje në parim, por i vetëdijshëm se rrethanat e reja sa i përket subvencionimeve të klubeve në Kosovë kanë ndryshuar. “Ka ndryshuar se tash ekziston edhe Ligji mbi subvencionimin e sporteve në Kosovë. Unë e di që edhe këtu është mbajtur një takim i tillë rreth sqarimeve, rreth shpjegimeve dhe mundësive që shumë biznese kanë tash mundësinë për të subvencionuar ish- klubet sportive. Dhe duke pasur parasysh këtë, edhe duke e pasur parasysh tash edhe një shqetësim qortim edhe personal, por edhe të subjektit politik, se me marrjen e pushtetit nga zoti Elezaj e tutje, jemi kritikuar qoftë nga LDK-ja, qoftë nga AAK-ja në mandatin e kaluar se politika po përzihet në sport. Dhe realisht ju e keni dhënë sinjalin më të madh të mundshëm që politika menjëherë me ardhjen në pushtet i ka future hundët pak, me ndryshimet që janë bërë në udhëheqësi të klubit. Por po

shpresoj se do të jetë për përmirësim të një zgjidhje të situatës në ofrimin e mundësive të donacioneve. Kështu që po them parimisht që edhe këto propozime të reja që u bënë për shtesa, që të njëjtat kërkesa i kemi pasur të rritet, edhe me kryetarin e pata këtë çështje, por ne kemi edhe një kërkesë: në nr. 3 te KV për femra, të rritet shuma nga 2 mijë në 4 mijë, për faktin se është një grup më i vjetër që funksionin, është me një kontribut bukur të konsiderueshëm, edhe kriteri tjetër është se edhe ne vitin e kaluar iu kemi ndarë 4 mijë euro. Po dua të them se ky klub është meritues, në mënyrë që kërkojmë se edhe për këtë të rritet shuma nga 2 mijë në 4 mijë. Përndryshe me të tjerat jemi në rregull”, ka konstatuar anëtari Berisha.

Petrit Palushi, tha se edhe unë pajtohem me këtë gjendje ju qysh e keni paraqitur, mirëpo kërkoj që Klubit të hendbollit “Dukagjini” për meshkuj t’i shtohet edhe 1 mijë euro dhe të paktën t’ju bëhet 5 mijë euro. Është mirë që këtë klub që sivjet do të garojë në superligë. Edhe do të shfaqet edhe përmes medieeve, edhe përmes televizioneve tona publike. Kështu që është mirë që këtë klub ta subvencionojmë dhe ta përkrahim në mënyrë që edhe këta hendbollistë të njihen njëjtë sikurse hendbollistët tjerë”, ka shtua anëtari Palushi.

Saranda Elezaj, meqenëse drejtori i DKRS bën ngritje të subvencioneve për disa klube, unë propozoj që te KV “Klina” të ngritet shuma nga 2 mijë euro në 2.500 euro, meqenëse janë vajza të reja dhe ju nevojitet përkrahja.

Enver Gashi, tha se me të gjitha pajtohem përpos me klubin e shahut. “Unë propozoj 2 mijë euro për klubin e shahut”, tha anëtari Gashi.

Violeta Zefi, theksoi se mendoj që subvencionimi i klubeve sportive duhet të bëhet në mënyrë sa më të barabartë. “Por, megjithatë, kërkoj po ashtu, që të ketë një favorizim të vogël për klubet e futbollit dhe volejbollit për femra. Unë jam e vetëdijshme që ky vendim për subvencione të klubeve sportive është bazuar në një analizë paraprake të nevojave të secilit klub, por mendoj që klubet sportive të femrave të përkrahen aq sat ë jetë e mundur në aspektin buxhetor”, ka pohuar anëtarja Zefi.

Tunë Dedaj, tha se unë kisha për t’u pajtuar me të gjithë parafolësit e mi për t’iu rritur shumat te sporti, por ato të rriten brenda mundësive buxhetore që kemi për t’i pasur. Për ta planifikuar që vitin e ardhshëm kur ta planifikojmë buxhetin për Kulturë, Rini e Sport të mos jetë ndarja nën 100 mijë euro”, tha Dedaj.

Xhevxhet Berisha, tha se vërtet që Kryetari bashkë me Ekzekutivin e kanë analizuar situatën, dhe besoj që kjo është mundësia që ka mundësi për t’iu ndarë klubeve, por duhet të kemi parasysh, që secili që e bën një kërkesë le ta bëjë një analizë më të saktë se sa është numri i stafit për secilin ekip, cilat janë rezultatet, në çfarë niveli të garave bën gara dhe pastaj le të bëhet një kërkesë. Por në bazë të rëndësisë KF “Dukagjini” i meshkujve, që futbolla edhe evropian dhe i nivelit botëror e ka rëndësinë e vet, është mirë që i është ndarë kjo shumë dhe pretendimet e tyre janë që të shkojnë në një rang më të lartë të garave. Për KF të femrave “Dukagjini” nuk dua të flas fare për arsye sepse që nga viti 2018 jam edhe kryetar i klubit dhe vërtet është një konflikt interesi dhe tek të gjitha klubet tjera që keni bërë këtë analizë besoj që duhet analizuar më qartë në bazë të rezultateve. Siç e dini KF i femrave “Dukagjini” garon në superligë dhe garon me dy klube, klubi për senior i cili është i ranguar në vendin e tretë në kuadër të superligës dhe për U-

16 është në vendin e dytë në nivel të Kosovës. Kështu që unë e përkrahi këtë që ka ndarë, edhe kryetari Elezaj dhe drejtorin për KRS, besoj që janë konsultuar edhe me drejtoritë tjera. Brenda mundësive është mirë për t'iu shtuar, por realisht ndoshta mundësitë janë këto. Kështu që e mbështes këtë propozim”, ka konstatuar prof. Berisha.

Tush Dedaj, tha se prej 47 mijë euro që janë planifikuar, 36 mijë euro shkojnë për KF “Dukagjini” për meshkuj. “Po e duket sikur po I biem murit me kokë. Për arsye se edhe pse e kemi kampionin e paraluftës dhe fituesin e kupës së Kosovës, si “Dukagjin” në futboll, por bash nga kjo shpërndarje nuk është në rregull, për arsye se edhe tash me këto shtesa që i potencoi drejtori, as gjysmën e buxhetit nuk janë duke e shfrytëzuar këto për sportet tjera. Për atë po them të shkojmë t'iu japim përparësi sporteve të cilat po tregojnë punë edhe suksese. Të gjitha këto sporte përpos shahut që nuk është sport janë në përparësi me futbollin. Nuk është e rëndësishme a është i popullarizuar apo nuk është i popullarizuar, është problemi çfarë efekti ka. E rëndësishme është kur udhëhiqet flamuri ose kur ngritet flamuri, kur brohorisin njerëzit për një kampion”, ka theksuar anëtari Dedaj.

Gjokë Lleshaj, tha se ndoshta e tepruam me diskutime disa herë, por pajtohëm plotësisht me këto propozime që janë shpërndarë në bazë të mundësive buxhetore që ka komuna, ndoshta në të ardhmen do të gjenden forma edhe për ta rritur. “Dihet se cilat klube nuk janë të njëjta as për nga numri, as për nga shpenzimet, mirëpo e rëndësishme është për të qenë aktive dhe funksionale të gjitha këto klube dhe për ta treguar veten. AERO- KLUBI është një klub që nuk di sa jeni të informuar, është një klub që ka një kosto jashtëzakonisht të lartë, por ka pasur dhe rezultate, që kanë qenë të prezantuara edhe nëpërmjet medieve. Më vjen mirë që edhe AEROKLUBI do të stimulohet, kisha kërkuar që po që se ka mundësi që t'i rritet kjo shumë. Uroj të jenë funksionale dhe të gjitha këto klube të kenë suksese. Pajtohëm plotësisht me këtë shpërndarje të këtyre mjeteve”, ka shtuar anëtari Lleshaj.

Avni Gashi, tha se për të mos i përsëritur ato çka u thanë nga diskutuesit, unë kam një pyetje ose më mirë të them një sqarim para se të shkojë në votim: “Kjo vlerë diku në shumën 47 mijë me këto ndryshime, a do të paguhen prej subvencioneve dhe transfereve apo janë prej Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport”, -pyeti anëtari Gashi.

Fadil Gashi, tha se një pjesë që kemi qenë në mandatin e kaluar, po flas në asamble këtu, përafërsisht kërkesat e klubeve ekzistuese të mandatit të kaluar, kur i kanë bërë disa kërkesa, disa projekte, nuk ndryshon fort shumë ajo. “Mund të ndryshojë sot që u bënë propozime të reja, por aty-aty sillen këto. Kërkesat nuk janë të njëjta, por as shpenzimet nuk janë të njëjta, që i krijojnë klubet, por as numrin e sportistëve nuk e kanë të njëjtë. Dhe diçka që është specifike në vete e klubeve, edhe e kërkesave të tyre. Prandaj për të qenë racionalë, besoj shumë që ky është një vendim, në pjesën e shumë vendimeve tjera që mund të marrim, për këtë vit po flas, sepse nuk përfundon këtu, edhe besoj që do të ketë edhe trajtime të tjera, edhe për klube, por edhe një herë desha ta them pa të keq, ka klube që e kanë avancuar në Komunën e Klinës, janë kategori të ndryshme që marrin pjesë në liga të ndryshme, por edhe ata që fillojnë sivjet e duan një stimulim të vogël, se edhe mos me i stimuluar mbesin aty. Nuk mund të dalin në vend të parë pa filluar diku ose pa hyrë në një ligë. Është diçka që alternativë dhe mundësi për t'iu dhënë”, ka shtuar kryesuesi Gashi.

Enver Berisha, tha se në bazë të kësaj analize të këtyre diskutimeve që po bëhen, po vijmë në përfundim me një çështje. “Edhe kjo le të shkojë kështu në këtë vit, nuk ka mundësi tash për t’u ndalur, përkatësisht për t’u kthyer mbrapa. Unë kam kërkesë që herëve të tjera, të gjitha klubet për të ardhur me plan, me projekt, me agjendë. Të dihet kush janë, kush janë sukseset të dihet, edhe mbi atë rezultat dhe atë angazhim që ata e bëjnë ne për të pasur parasysh dhe t’i stimulojmë. Kështu që do të jetë shumë më e qartë edhe më e lehtë edhe për ne, kur kemi informacion të plotë kur kemi njohur, kush janë, çfarë po ndodh, ku janë rezultatet?”, pohoi anëtari Berisha.

Fadil Gashi, tha se Enver na ke ndihmuar shumë, të njëjtën gjë desha ta potencoj edhe unë, le të shkojnë këtë vit me këto. “Me të drejtë është, klubet e bëjnë një projekt, me drejtorin dhe ne i shqyrtojmë bashkërisht këtu. Këtu jemi, i shohim kërkesat, i shohim mundësitë tona buxhetore, sepse ju e keni buxhetin tonë, është buxhet i përbashkët, nuk ndryshon, dhe shpërndajmë për aq sa kemi mundësi dhe klubet do të trajtohen veç e veç”, shtoi Kryesuesi.

Skënder Merturi, tha se për sa po shihet është një dakordancë e përbashkët dhe ju kisha falënderuar të gjithëve, vetëm një shpjegim: të gjitha këto klube, 10 klube që janë, janë të detyruara për të dhënë raport për këto mjete që ne si Kuvend ose si Ekzekutiv që jeni duke i dhënë dhe jeni duke i votuar. Në fund, të gjitha këto klube do të japin një raport financiar, edhe DKRS e bën pranimin dhe mospranimin edhe merr vërejtje për klubet të cilat nuk bien raporte. Edhe për vitin tjetër ne ju kemi thënë se duhet për të prurë projektet qysh klubet mendojnë për të realizuar për vitin e ardhëm”, ka pohuar drejtori Merturi.

Xhevxhet Berisha, kërkoj që të dal nga procesi i votimit për shkak se është konflikt interesi, pasi që është kryetar i KF “Dukagjini” për femra. Anëtari Berisha u largua nga procesi i votimit.

Fadil Gashi, të konstatohet në proces që anëtari Xhevxhet Berisha tërhiqet nga procesi i votimit për shkak se është konflikt interesi.

Fadil Gashi, prezantoi shumën e mjeteve të ndara për secilin klub veç e veç:

- KF “Dukagjini” (meshkujt) – 30 mijë
- KF “Dukagjini” (femrat) – 6 mijë
- KV “Dukagjini” (femrat) – 4 mijë
- KH “Dukagjini” (meshkujt) – 5 mijë
- KB “Dukagjini” (meshkujt) – 2 mijë
- KH “Dukagjini” (femrat) – 2.500
- KV “Klina” (femrat) – 2 mijë
- K. i ping-pongut “Dukagjini” – 500
- Klubi i shahut - 500
- Klubi i Aero – klubi – 50
-

Kryesuesi vuri në votimet propozimet.

Me vota unanime (26) u miratuan propozimet për ndarjen e mjeteve për klubet sportive.

Zenun Elezaj, tha se besoj që janë edhe mundësitë që i ka Kryetari, edhe me kërkesën e juaj, do ta rrisim. “kështu që unë kam pasur shumë ankesa prej klubeve dhe kam bërë përpjekje për t’ju sqaruar se do të mundohemi për të kyrsyer nga subvencionet që kemi. :Për shembull: Te Festivali “I këndojmë lirisë”, shpenzojmë pak më shumë mallra dhe shërbime, kursejmë subvencione edhe bashkërisht në pjesën tjetër të vitit prapë besoj që do të kemi mundësi të ndërhyjmë dhe t’u ndihmojmë klubeve. Unë kisha bërë edhe një kërkesë për gjithë neve që të punojmë bashkërisht, për të ndaluar iniciativa, por që këtë klubin e volejbollit, bashkërisht të gjithë, t’i bashkojmë një klub, të jetë një klub i vetëm dhe të garojnë me potencialin më të madh dhe mundësitë më të mëdha. Domethënë kjo është thjeshtë një kërkesë që ne të gjithë të punojmë dhe t’i unifikojmë, sepse Klina nuk është aq e madh për të pasur dy klube në këtë kategori ”, ka konstatuar kryetari Elezaj.

Fadil Gashi, tha se është një rrugë, një kurs zyrtar, sipas rregullores subvencionet deri në 2 mijë euro kryetari ka mundësi edhe pa vendim të asamblesë për t’i ndarë. “Për hir të korrektësisë, transparencës, le të mbetet ajo pjesa tjetër aty ku ka mundësi për t’u sanuar edhe pak, le të jetë prej Zyrës së Kryetarit, sepse deri në 2 mijë euro mund ta plotësojë pa vendime tona, por me këto propozime edhe një herë po e vej në votim”, theksoi kryesuesi Gashi.

Me vota unanime (26) u miratuan propozimet për ndarjen e subvencioneve për klubet sportive të Komunës së Klinës.

Pika e tetë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e Këshillit organizativ të Festivalit Folklorik “I këndojmë lirisë” (ref. DKRS).

Kryesuesi fjalën e barti te drejtori i DKRS, z. Skënder Merturi.

Skënder Merturi, tha se kemi filluar përgatitjet për festival, i cili është një festival me vlera për mua kombëtare, mendoj që jemi edhe në kohë. “Kemi filluar përgatitjet për këtë festival, i cili është tradicional edhe do të organizohet edhe këtë vit siç do herë.

Kemi menduar të shkuar me këtë përbërje:

Anëtarët e KO për festivalin “I këndojmë lirisë -2018, mendojmë si drejtori të jenë me këtë përbërje:

1. Skënder Merturi – DKRS
2. Besim Hoti - nënkryetar
3. Zyra e Prokurimit
4. Zyra e Financave
5. Drejtoria e Administratës
6. DKA
7. DSHP
8. DSH
9. DI

10. Elmi Berisha, 11. Elmi Salihu, 12. Alban Gashi, 13. Mujë Gashi, 14. Liridon Rexha, 15. Rexhë Buqani, 16. Idriz Berisha, 17. Ndërm. “Ambienti”, 18. Dibran Fylli, 19. Halit Gashi, 20. Fatmir Berisha, 21. Grupi i gazetarëve: Agron Bojaj, Mimoza Bajraktari dhe

Enver Maloku, 22. Përfaq. të fshatit Qabiq, 23. Hajdin Balaj, kryetar i Veteranëve të Luftës, 24. një familjar i Mujë Krasniqit, 25. Policia e Kosovës, 26. Ilir Raci, këtu kisha kërkuar përfaq. të partive politike që janë në AK, 27. Qëndrim Millaku, 28. Vlora Tafilaj, 29. Besnik Dragaj, 30. Ismet Musaj, 31. Rasim Gashi, 32. Tunë Dedaj, 33. Zeqir Morina, 34. Saranda Zeqaj dhe 35. Xhevxhet Berisha dhe Kaltrina Mrijaj.

Këto janë propozimet që ne i kemi bërë si drejtori, këtu i shtohen KO edhe propozimet që i bëni ju si anëtarë, si përfaq. të partive politike që marrin pjesë në KK. Secila parti përfaqëson me nga një anëtar”, ka konstatuar drejtori Merturi.

Fadil Gashi, theksoi se e kemi të qartë, neve na kërkohet prej kuvendit të kemi nga një përfaqësues nga secili subjekt pjesë të këshillit. Kryesuesi kërkoi që të procedohet me propozime.

Vilota Zefi, tha se meqenëse paska numër të konsiderueshëm të anëtarëve që do të jenë pjesë e këtij këshilli organizativ, mendimi im dhe propozimi im personal është që të kemi vetëm 2 përfaqësues, një nga pozita dhe një nga opozita.

Fadil Gashi, theksoi se ky këshill ka për obligim që pas festivalit për të prurë raport dh eta shohim ne raportin e punës, të shpenzimeve, të organizimeve etj.

Petrit Palushi, tha se mbasi që ky numër qenka i madh nuk do të thotë asgjë edhe nëse i propozojmë 2-3 vetë nga grupet parlamentare, edhe raporti këtu tek ne do të vijë, edhe anëtarët tanë të inkuadrohen në këtë raport dhe e njohim pak më mirë gjenden. “Unë prej grupit tonë parlamentar propozoi Tunë Dedaj”.

Fadil Gashi, tha se nuk kemi kufizim, i kemi dy propozime, një që e tha Violeta.

Esat Raci, tha se nga GP i PDK-së propozoi Zeqir Morinën.

Enver Gashi, në emër të GP të LDK-së propozon Saranda Zeqën.

Saranda Elezaj, në emër të GP të “Vetëvendosjes” propozon Xhevxhet Berishën.

Kryesuesi vuri në miratim përbërjen e plotë të KO të festivalit “I këndojmë lirisë”.

Me vota unanime (26) u miratua propozimi për anëtarë të KO të festivalit “I këndojmë lirisë”.

Pika e nëntë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës në afat të shkurtër dhe të gjatë.

Fadil Gashi, tha se ju e dini është kërkesë ligjore dhënia në shfrytëzim të hapësirave publike. “Ligji kërkon, paraprakisht për të respektuar procedurat e dhënies në shfrytëzim të hapësirave publike ne duhet të themelojmë këtë komision dhe menjëherë pas këtij komision duhet për të

themeluar Komisionin për ankesa. Ju isha lutur që t'i zgjidhni ata anëtarë, që do të përfaqësojnë Kuvendin. Ligji kërkon që në komision të jenë 7 anëtarë, 3 nga KK, 3 nga ekzekutivi, vjen nga kryetari i Komunës dhe 1 nga SHC – ekspert i fushës. Kështu e sanksionon ligji. Nga anëtarët e KK, t'i marrim tri propozimet nga grupet më të mëdha që përfaqësojnë në Kuvend dhe të procedojmë pastaj me pranimin e tri propozimeve tjera që e plotësojnë këtë vendim, që vijnë nga zyra e kryetarit dhe 1 nga SHC dhe e kompletojmë këtë komision”, theksoi kryesuesi, i cili në vijim hapi debatin”, pohoi kryesuesi Gashi.

Tunë Dedaj, në emër të GP të AAK-së propozon Petrit Palushin.

Esat Raci, në emër të PDK-së propozon Zeqir Morinën.

Violeta Zefi, në emër të LDK-së propozon Enver Gashin.

Fadil Gashi, theksoi se po që se na kthejnë për seancën e radhës për shkak të mungesës së përfaqësimit të gjinisë, të mos befasoheni.

Enver Berisha, tha që ekzekutivi le të përfaqësohet me kriterin e gjinisë dhe ta plotësojë këtë kriter.

Kryesuesi vuri në miratim propozimet.

Me 26 vota u miratua komisioni.

Pika e dhjetë: Formimi i Komisionit të ankesave lidhur me shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim.

Fadil Gashi, sqaroi që komisioni duhet pasur 5 anëtarë sipas ligjit: 2 ekzekutivi, 2. Kuvendi, edhe 1 SHC.

Kryesuesi hapi debatin.

Esat Raci, propozon Besart Hotin.

Saranda Elezaj (“Vetëvendosje”), propozon Ibrahim Mehmetajn.

Dy mbesin prej Ekzekutivit dhe 1 nga SHC në mënyrë që të plotësohet komisioni.

Vuri në miratim propozimin.

U miratua unanimit.

Pika e njëmbëdhjetë: Rishqyrtimi i kërkesës së MPL për Komitetin për Komunitete dhe shqyrtimi i peticionit i Partisë Liberale Egjiptase - dega në Klinë.

Fadil Gashi, theksoi se ju e keni marrë sikurse unë që e kam një peticion të nënshkruar prej bukur do vetëve, por shihet qartë se është prej një dore, mirëpo kërkesa jonë ligjore na obligon për ta shqyrtuar, kjo është e para. “E dyta, u njoftuam me kërkesën e ministrisë për rishqyrtim

vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete dhe tash nëse ju pajtoheni ne i kemi dy alternativa: një për të proceduar sot për t'i shikuar mundësitë të përfshihen edhe komunitetet tjera jo vetëm kjo që ka bërë peticion. Ne kemi pasur kërkesa edhe prej komuniteteve tjera, edhe të bashkësive tjera që jetojnë në Klinë. Megjithatë ne e kemi pasur marrë një vendim, tash e kemi të kthyer atë vendim për hir të plotësisimit të gjinisë femërore. Ne duhet për ta respektuar atë kërkesë dhe kemi mundësi për të proceduar në seancën e radhës, jemi brenda afatit prej 30 ditor, sepse seanca e radhës do të jetë diku më 25- 26 prill na rrok si datë, dhe brenda afatit ne mund ta shqyrtojmë. Nëse pajtohet kuvendi që pjesa e gjinisë femërore të plotësohet prej minoriteteve tjera. Të bëhet kërkesë, veç a pajtoheni ju, kërkesa është publike, kjo është prej seancës që ata le të shikojnë mundësinë e mbulimit të kësaj hapësire. Ju e dini se Kuvendi ka 3 anëtarë në këtë komitet, ndërsa 4 të tjerë janë të bashkësive tjera që jetojnë në Klinë. Dhe në këtë rast, po shfrytëzoj këtë hapësirë për t'ju bërë thirrje gjatë kësaj periudhe, derisa ne ta shpërndajmë materialin për seancën e radhës të na vijnë propozimet, për t'i proceduar ne propozimet edhe për të vendosur edhe në seancë. Rreth peticionit kam obligim për t'ju informuar se ky peticion ka ardhur pas vendimit që ne kemi nxjerrë në seancë. Ju e dini para vendimit ne kemi pritur propozimet, edhe SHK, nuk kanë sjellë këta propozimet, meqenëse nuk ka as propozim në peticion, vetëm kundërshtojnë propozimet. Ky peticion ka ardhur mbas vendimit, duhet tri propozime për të na ardhur. Le të mbetet edhe kjo edhe kërkesat tjera eventuale le ta kenë këtë kohë në dispozicion sa kanë, në seancën e radhës ne të ulemi e të vendosim”, ka konstatuar kryesuesi.

Enver Berisha, tha se duke i ditur statistikën që i ka komuna edhe që i keni edhe ju, në raport me numrin e banorëve sa i përket komuniteteve në Komunën e Klinës, realisht komuniteti egjiptas është numri më i madhi i bano4rëve. “Këto shifra ekzistojnë në Zyrën për komunitete, mirëpo mund t'i ketë edhe Zyra e nënkryetarit apo kush i ka. Në një mënyrë unë paksa ju jap të drejtë këtyre në përfaqësimin e tyre për shkak se dhe janë në numër më së shumti në komunën tonë, komuniteti egjiptas. Edhe pajtohem plotësisht që le të mbetet deri në seancën e radhës me kusht që ju pak të angazhoheni dhe mundësitë e bisedave dhe kontakteve që ata t'i keni përfaqësimet e veta të gjinisë femërore dhe përfundon edhe kjo çështja e këtij komiteti”, ka shtua anëtari Berisha.

Fadil Gashi, tha se desha vetëm edhe një sqarim, te ky komitet, se këta janë të përfaqësuar me një anëtar, me atë propozim që ne kemi marrë vendim, mirëpo këta njëri-tjetrin nuk po e pranojnë. “Këtu është telashja, këta po ashtu po kanë edhe subjekte të ndryshme nuk i kishin të njëjtë, edhe tash është alternativë cili është më përfaqësues se sa tjetri, ne nuk po kemi ndonjë mekanizëm që mund ta peshojmë”, tha kryesuesi.

Tunë Dedaj, tha se kam qenë katër vite me Sahi Balinë në Komitetin për Komunitete dhe më ju thënë të vërtetën se ai persona ka punuar shumë bukur shumë për pakicat që janë në komunën e Klinës, nuki di asgjë te ai”, tha anëtari Dedaj

Fadil Gashi, tha se as ne nuk dimë asgjë të keqe as nuk po diskutojmë, mirëpo ata ndër vete nuk po pajtohen, këtu është telashja. “Për neve cilindo që nga fillimi, cilindo që na propozojnë ne e pranojmë. Mbase po vijnë propozimet po vjen shkresa tjetër që s'po pranojnë. A pajtohemi që në seancën e radhës të shkojmë me të dyja, edhe këto që kanë ardhur në kundërshti le të plotësohen, le të bisedojnë ata mes vete, ne nuk kemi tjetër mundësi vetëm nga një përfaqësues mund ta kemi

këtu. Le të mbetet gjinia si hapësirë, shqyrtimin e petitionit ne veç e kemi zënë afatin brenda 60 ditëve, edhe afati tjetër 30 ditore për rishqyrtim të vendimit e kemi për seancën e radhës. A po pajtohemi në këtë mënyrë”, shtoi kryesuesi Gashi.

Valmir Bacaj, tha se ndoshta do të kishte qenë e rrugës për të kërkuar edhe një herë sqarim prej MPL se në LVL nuk e kanë përcaktuar përfaqësimin gjinor, nuk e kam gjetur askund, nuk parashihet as në statutin e komunës së Klinës për përfaqësimin gjinor për komitetin për komunitete ashtu siç parashihet në KPF, edhe përfaqësimi në Kuvend është 30 për qind i femrave, prandaj ne e kemi të pamundur 50 për qind për ta kompletuar me përfaqësim gjinor.

Fadil Gashi, theksoi se absurdi tjetër është edhe më i madh që kjo që po thua. “Absurdi tjetër është se ne i kemi themeluar, realisht i kemi 9 komitete vetëm për dy nxjerrin telashe, ato të tjerat i kemi të përfaqësuara me gjithë meshkuj dhe nuk i këqyr kush. Edhe për mua është absurd kjo. Ose të na i kthejnë të gjitha, ose të mos merren vetëm me dy kur i kemi edhe këto tjerat. Ne jemi të shtrënguar për të rishqyrtuar sepse tash kemi shkresë zyrtare. Ata thirrën në këtë ligjin për barazi gjinore, aty është kërkesa kryesore, edhe thirret te 50 përqindëshi”, shtoi kryesuesi Gashi.

Enver Berisha, tha se mendoj që është një situatë pak e paqartë rreth mëditjeve të asamblastëve. “Deri me tash realisht 5 seanca janë mbajtur, mendoj që diçka nuk është në rregull me pagesën. Ju kam thënë edhe në takim me shefat e grupeve, është mirë për të kërkuar nga DF se është kështu. Nëse është në rregull, në rregull, mirëpo mendoj se nuk është në rregull”, tha anëtari Berisha.

Fadil Gashi, tha se unë po marr obligim po që se keni këso pengese ejani te unë e thërrasim drejtorin dhe merrem vesh aty për aty. “Atë përfundojmë ke këtë Komitetin për Komunitete, mbetet për seancën e radhës. Po bëjmë ftesë për bashkësitë që jetojnë në Klinë, mundësisht t’i zëvendësojmë propozimet e gjinisë femërore, ta plotësojmë si kriter gjinor, edhe komunitetet tjera që s’po pranojnë njëra-tjetrën le ta kenë hapësirën të koordinimit deri në seancën e radhës. A po pajtohemi kështu?”-pyeti Kryesuesi dhe vuri në votim propozimin. Me vota unanime (26) u miratua propozimi.

Tunë Dedaj, tha se seanca inauguruese nuk është paguar, kjo është gjëja më e keqe. Unë kam njoftuar drejtorin”, tha anëtari Dedaj.

Fadil Gashi, njoftoi anëtarët që përmes e-mailit zyrtar do t’i marrin për 4 Prill agjendën komplet ju vejnë në adresë komplet për Ditën e të zhdukurve.

Kryesuesi falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë.

Seancën e konstatoi të përfunduar.

Seanca përfundoi në orën 12.00.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI

